

DPK | DHP

03-907/2012

03

06.03.2012

GJL.Nr.180/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani, anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga e pandehura Sladjana Vasic nga fsh.Lepinjë KK Graçanicë, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24902/2011 të dt. 23.12.2011, në bazë të nenit 39, al.3, dhe 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 10.02.2012, mori

AKTVENDIM

Ankesa e paraqitur është pjesërisht e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i goditur ashtu që e pandehura Sladjana Vasic për kundërvajtjen e kryer nga neni 6 pika 2 e ndëshkuar sipas nenit 16 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, dënohet me gjobë në shumë prej 400 Euro.

Dënimin e shqiptuar e pandehura është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së këtij aktvendimi e në të kundërtën do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 26 ditësh.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24902/2011 të dt. 23.12.2011, ka shpall përgjegjës të pandehurën Sladjana Vasic nga fsh.Lepinjë KK Graçanicë, sepse si zëvendës komisarë e NJ-së në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë pranë Agjencionit kundër korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë e njoftuar se është përfshirë në listën e zyrtarëve të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 6. 2 lidhur me nenin 16 par.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, për të cilën kundërvajtje të pandehurës i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 800 Euro. Me të njëjtin aktvendim e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi e pandehura Sladjana Vasic, ka paraqitur ankesë: për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e anekses. Thekson se prapë nuk është vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të plotë se nuk e ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë nga shkaku se asnjëherë nuk iu ka ikur obligimeve shoqërore, se shkresën përmes E-maili e ka marrë në gjuhen shqipe dhe nuk e ka kuptuar çka kërkohet prej saj dhe kompetentet nga teknologjia informative kanë deklaruar se është e pamundur të kthehet E-maili i shlyer. Më tej thekson se gjyqtari ka qenë i ashpër duke ia shqiptuar dënim me gjobë prej 800 Euro, duke pas parasysh se disa për të njëjtën kundërvajtje janë dënuar shumë më pak. Thekson se e ka përmbushur obligimin për deklarin e pasurisë atëherë kur janë dhënë sqarimet e duhura dhe shkak i vonës ka qenë mungesa e informimit të drejtë, pastaj gjoba është e padrejtë dhe shumë e lartë, se është mbajtëse e familjes pesë anëtarëshe dhe me këtë i vihet në pyetje ekzistenca e tërë familjes, meqë merë bruto të ardhura së bashku me honorar në lartësi prej 430 Euro, andaj ka propozuar që aktvendimi i atakuar të abrogohet në rishqyrtim dhe rivendosje, ose të ndryshohet e ajo të lirohet nga përgjegjësia dhe dënimi i shqiptuar.

3.

cilën është shpallur përgjegjëse i shqiptoi dënimin me gjobë në të holla në shumë prej 400 Euro, duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e përgjegjësisë, veprën e kryer dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra dhe se me këtë gjobë ndaj saj do të arrihet qëllimi i ndëshkimit që e pandehura në të ardhmen të mos kryej vepra të këtilla dhe të ngjashme.


Nga se u tha më lartë e në bazë të nenit 221 të LMK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL.Nr.180/2012 të dt.10.02.2012

SEK.JURIDIKE
Saniye Salihu



KRYETARI I KOLEGJIT,
Ramiz Kuqi